

Shtyhet thirrja për aplikime për bursa për stafin e Universitetit të Tiranës në Universitetin Aristotel të Selanikut, Greqi, për vitin akademik 2020-2021.

Në kuadër të programit Erasmus+ është shtyrë thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për stafin e Universitetit të Tiranës në Universitetin Aristotel të Selanikut, Greqi, për vitin akademik 2020-2021.

<https://eurep.auth.gr/>

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

-Shkëmbimin e stafit me kohë të plotë për mësimdhënie/trajnim;

Kohëzgjatja:

- 5 ditë +2 ditët e udhëtimit;

Bursat përfshijnë:

-Kompensimin për stafin (140 EUR në ditë për stafin);

- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin me kohë të plotë:

- CV + Lista e publikimeve(stafi akademik) (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Letër motivimi (në gjuhën angleze);
- Vërtetim Punësimi (në gjuhën shqipe);
- Certifikata e gjuhës së huaj;
- Vetëdeklarim nëse keni kryer/jeni shpallur ose jo më parë fitues në një mobilitet Erasmus+ (nëse po, ku);
- Letër suporti nga Universiteti pritës, referohuni linkut:

<https://eurep.auth.gr/en/coordinators/international>

- Plani i mobilitetit*;

Për të shkarkuar formatin e Planit të mobilitetit për mësimdhënie klikoni në adresën:

https://unitiredu-my.sharepoint.com/:w:/g/personal/iro_unitir_edu_al/EQM62ekVVWdPiBIOdRfUpRsBPtmjgS9qNTZ2tHKhpwzEsQ?e=TcsrLm

*Plani i Mobilitetit për mësimdhënie është një dokument, në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së mësimdhënies. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe nga personi përgjegjës në Rektorat, i cili është Koordinatori Institucional i Erasmus +.

Për të shkarkuar formatin e Planit të mobilitetit për trajnim klikoni në adresën:

https://unitiredu-my.sharepoint.com/:w:/g/personal/iro_unitir_edu_al/EfdfRJ6o-4hAshDRGhxxg7QBqOf02DEilDCY4-nzNjVAcg?rttime=4ZNxdix72Eg

*Plani i Mobilitetit për trajnim është një dokument, në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së trajnimit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe nga personi përgjegjës në Rektorat, i cili është Koordinatori Institucional i Erasmus +.

Afati për aplikim: 26 Nëntor 2020

Dokumentat duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Studentët, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë, si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin iro@unitir.edu.al.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: iro@unitir.edu.al.

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!